



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 46 prot.

Kamëz, më 25.6.2025

V E N D I M
Nr. 39.Datë 25/6 2025
MBI

“NDRYSHIMIN NË VENDIMIN NR.43, DATË 18.11.2019 “PËR ORGANIZIMIN E VENDPARKIMEVE TË TRANSPORTIT TAKSI 4+1 NË TË GJITHË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ” TË NDRYSHUAR”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.06.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.34 Datë 20.06.2025 mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportet Rugore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 15 datë 24.7.2007 “Për Kriteret dhe Procedurat e Lëshimit të Licencave, Autorizimeve dhe Certifikatave Për Ushtrimin e Veprimtarisë në Transportin Rugor” i Ndryshuar, Vendimit nr.43, datë 18.11.2019 “Për Organizimin e Vendparkimeve Të Transportit Taksi 4+1 Në Të Gjithë Territorin e Bashkisë Kamëz”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Transportit, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit në Vendimin nr. 43, datë 18.11.2019 “Për organizimin e vendparkimeve të transportit taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz” të ndryshuar.
2. Në nën-pikën 1(një) të pikës së parë që i bashkëlidhet Vendimit nr. 43, datë 18.11.2019 “Për organizimin e vendparkimeve të transportit taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz” të ndryshuar, të hiqen 5 vende parkimi, duke bërë ndryshimet si më poshtë vijon:

Ishte: Rruga Skenderbeu Kamëz.....11 vend parkimi

Bëhet: Rruga Skenderbeu Kamëz.....6 vend parkimi

3. Ndryshimi i propozuar me vendndodhjen e saktë të vendparkimeve taksi 4+1 për rrugën e sipërcituar do të jenë sipas relacionit shpjegues të vendimit dhe harta përkatëse.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Licencimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI